



Nr. i prot. 849 Më 02.03.2021
Br. prot. 849 Dt. 02.03.2021
RAHOVEC - ORAHOVAC

Mbështetur në Ligjin Vetëqeverisje lokale Nr.03/L-040, neni 14,pika 14.2, Ligjin për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Statutit të komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës: 29.03.2017, Neni 18 pika 4 të Rregullores për Taksa komunale 01/80, vendimit të Kuvendit Komunal të Rahovecit, 01 Nr.136 të datës: 30.11.2020, Komisioni vlerësues i ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme në shfrytëzim i caktuar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit nr.2055, të dt. 28.06.2019, shpall këtë:

NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK

PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR

1. Njoftimi publik për dhënie e lokaleve afariste shfrytëzim afatshkurtër në Palestrën Sportive “Mizahir Isma” p.n. në Rahovec në pronësi të Komunës përmban si në vijim:
2. Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim janë në zonën kadastrale Rahovec evidentuar P.SH e Kosovës në qytet, me nr.të certifikatës së pronësisë si më poshtë:

- 2.1. Lokali afarist Nr.1 sipas certifikatës së pronësisë Nr.0-71510057-106-0-2-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 58 m² (pesëdhjetë e tetë metra katror);
- 2.2. Lokali afarist Nr.2 sipas certifikatës së pronësisë Nr.0-71510057-106-0-3-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 63 m² (gjashtëdhjetë e tre metra katror);
- 2.3. Lokali afarist Nr.3 sipas certifikatës së pronësisë Nr.0-71510057-106-0-4-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 63 m² (gjashtëdhjetë e tre metra katror);
- 2.4. Lokali afarist Nr.4 sipas certifikatës së pronësisë Nr.0-71510057-106-0-5-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 61 m² (gjashtëdhjetë e një metër katror);
- 2.5. Lokali afarist Nr.5 sipas certifikatës së pronësisë Nr.0-71510057-106-0-6-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 60 m² (gjashtëdhjetë metra katror);
- 2.6. Lokali afarist Nr.6 sipas certifikatës së pronësisë Nr.0-71510057-106-0-7-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 60 m² (gjashtëdhjetë metra katror);
- 2.7. Lokali afarist Nr.7 sipas certifikatës së pronësisë Nr.0-71510057-106-0-8-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 60 m² (gjashtëdhjetë metra katror);
- 2.8. Lokali afarist Nr.8 sipas certifikatës së pronësisë Nr.0-71510057-106-0-9-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 60 m² (gjashtëdhjetë metra katror);

2.9. Lokali afarist Nr.9 sipas certifikatës së pronësisë Nr.0-71510057-106-0-10-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 60 m² (gjashtëdhjetë metra katror);

2.10. Lokali afarist Nr.10 sipas certifikatës së pronësisë Nr.0-71510057-106-0-11-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 63 m² (gjashtëdhjetë e tre metra katror);

1. Njoftimi për ankand publik përfshin:

1.1. Çmimin fillestar të pronës që është objekt i dhënies në shfrytëzim përmes ankandit publik:

1.2. Çmimin fillestar për dhënien e pronës në shfrytëzim – lokalet afariste në Palestrës Sportive “Mizahir Isma” në Rahovec rr.”Xhevat Kasapi” p.n. - Rahovec do të jetë 4.00 €/m².

1.3. Afati i dhënies në shfrytëzim i pronës:

Afati i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës – lokalet afariste në Palestrën Sportive “Mizahir Isma” Rahovec (rr. “Xhevat Kasapi” p.n.) do të jetë afatshkurtër prej pesë (5) vitesh.

1.4. Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik dhe data e fundit e dorëzimit të ofertave:

Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik për dhënien e pronave për shfrytëzim afatshkurtër është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në web-faqen e Komunës, në vendet publike, elektronike dhe të shkruara. Ofertat dorëzohen të mbyllura nëpërmjet Zyrës së Prokurimit në Rahovec nga data: 03.03.2021, deri më datë: 17.03.2021, nga ora 09:00 deri në ora 15:00.

Vendi, koha ku do të mbahet ankandi publik:

Në sallën e Kuvendit Komunal me dt. 19.03.2021 me fillim në ora 13:30, do të bëhet hapja e ofertave të mbyllura dhe të njëjtat do të bëhen publike gjatë hapjes, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit në ankand publik.

1.5. Kushtet apo kufizimet mbi dhënien e të drejtave për shfrytëzim:

1.5.1. Lokali ose prona nuk mund të përdoret për qëllime tjera përpos siç është përcaktuar në planin investiv dhe e njëjta nuk mund të bartet në personin e tretë.

2. Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në ankand publik;

2.1. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik,

2.2. Personat fizik krahas aplikacionit në kuvertë duhet të ofrojnë edhe kopjen e letërnjoftimit (me afat), dëshminë mbi pagesën e tatimit në pronë (jo më e vjetër se një muaj) dhe deklaratën nën betim të nënshkruar (ky dokument është pjesë e ankandit).

2.3. Personat juridik, krahas aplikacionit në kuvertë duhet të bashkëngjisin edhe këto dokumente:

a. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me informata (NUI).

b. Vërtetimin e taksës komunale në afarizëm,

c. Vërtetimin nga Administrata Tatimore e cila ka afatshmëri.

d. Deklarata nën betim e nënshkruar dhe vulosur (deklarata është pjesë e ankandit)

3.1. Kriteret e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të lokaleve afariste në Palestrën Sportive “Mizahir Isma” oferta ekonomikisht më e favorshme:

- Projekti investiv për 5 (pesë) vite**30 pikë**
- Çmimi më i lartë i qirasë mujore**25 pikë**
- Personat juridik mbi 24 muaj përvojë pune (të dëshmohet me certifikatë të biznesit)**10 pikë**
- Aplikues në sektorin e gastronomisë dhe aktivitetet sportive**10 pikë**
- Gjenerimi i vendeve të reja të punës - max **20 pikë**
- Aplikuesi femër **5 pikë**
- **Kriteret vlejné për personat fizik dhe juridik.**

2.4. Pjesëmarrësve në konkurrim iu garantohet e drejta që të:

2.4.1. Informohen lidhur me procedurat e ankandit publik,

2.4.2. Shohin pronën që do të jepet në shfrytëzim,

2.4.3. Kanë qasje në dokumentacionet e pronës,

2.4.4. Tërhiqen nga ankandi jo më vonë se tre (3) ditë para mbajtjes së ankandit publik.

2.4.5. Fituesi duhet të nënshkruaj regjistrin e procedurës së ankandit publik. Nëse informatat e dhëna nga ofertuesi dëshmohen si të pasakta, komisioni ka të drejtën që të refuzojë dhënien e pronës në shfrytëzim.

3. Raporti i vlerësimit të ofertave dhe procedura e nënshkrimit të kontratës;

3.1. Komisioni vlerësues brenda tri (3) ditë pune nga përfundimi i vlerësimit të ofertave në ankand publik, harton raportin përfundimtar për përmbylljen e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

3.2. Raporti përfundimtar i komisionit vlerësues të ofertave të ankandit publik përmban:

3.2.1. Një kopje të shpalljes së ankandit publik;

3.2.2. Procesverbalin e procesit të ankandit publik;

3.2.3. Rekomandimin e komisionit për përzgjedhjen e fituesit;

3.2.4. Një kopje e protokolluar të ofertës së përzgjedhur;

3.2.5. Ankesat e parashtuara nga pjesëmarrësit në ankand publik.

4. Pas miratimit të ofertës së përzgjedhur nga komisioni vlerësues, njoftimi i dërgohet fituesit dhe i njëjti publikohet në tabelën e shpalljeve dhe në web - faqen e Komunës. Ofertuesi me çmimin më të lartë të ofruar në zarfe të mbyllura do të shpallet fitues gjatë procesit të hapjes së ofertave.

5. Pala e pakënaqur me vlerësimin e komisionit, ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë komisionit për shqyrtimin e ankesave në afat prej shtatë (7) ditësh.

6. Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, nënshkruhet nga Kryetari i komunës dhe fituesi i zgjedhur, brenda 15 ditësh pune nga data e miratimit të ofertës nga ana e komisionit vlerësues.

Vërejtje: Tërheqja e aplikacioneve për ankand publik bëhet në formë fizike në Zyrën e Prokurimit në Rahovec.

Rahovec, 02.03.2021

Komisioni vlerësues i ofertave